



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
GJIROKASTËR

Nr. 23/4 Prot.,

Gjirokastër më datë 23.04.2025

VENDIM
Nr. 23/4, datë 23.04.2025

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË DOKUMENTAVE QË DO TË OFROHEN NË
FORMATIN E TË DHËNAVE TË HAPURA PËR GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, GJIROKASTËR”.**

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 38 të Ligjit nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, të shkresës nr.3147/3, datë 04.04.2025 të Këshillit të Lartë, Gjyqësor si dhe të shkresës nr. 876, datë 07.03.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit, Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër, i mbledhur sot më datë 23.04.2025, i përbërë nga Znj. Entela Selmanaj, Kryetare, Znj. Orinda Lloshi, Anëtare dhe Znj. Donalda Feruni (Kalemi), anëtare,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së dokumentave ekzistuese referuar fushës së veprimtarisë dhe detyrave publike që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura, si më poshtë:

- a) Vendime të Këshillit të Gjykatës.
- b) Dokumentimi i mbledhjeve të Këshillit të Gjykatës.
- c) Njoftime/Shpallje.
- d) Kontakte të Nëpunësit për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun.
- e) Formularë të vetëdeklarimit të punonjësve funksionarë. publikë dhe nëpunës civilë gjyqësorë.
- f) Informacion mbi procedurat e prokurimit.
- g) Informacione statistikore.

2. Ngarkohet Kancelarja dhe Sektori i IT, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Median për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, sot më datë 23.04.2025.

KRYETARE E KËSHILLIT TË GJYKATËS ANËTARE E KËSHILLIT TË GJYKATËS
(ZV/KRYETARE) ENTELA SELMANAJ (GJYQTARE) ORINDA LLOSHI

**ANËTARE E KËSHILLIT TË GJYKATËS
(KANCELARE) DONALDA KALEMI (FERUND).**

